REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS/ TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

BULETINI MUJOR

Aktivitetet e Këshillit Prokurorial të Kosovës

Janar 2020

1. Aktivitetet e Këshillit Prokurorial të Kosovës

Finalizohet Plani i punës së KPK-së për vitin 2020

Prishtinë, 8 janar 2020 – Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Bahri Hyseni, ka mbajtur takim me anëtarë të Këshillit, Drejtorin e Përgjithshëm të Sekretariatit dhe Drejtorin e Njësitit, si dhe me udhëheqës të njësive të tjera të administratës, ku ka diskutuar për finalizimin e Planit të punës së KPK-së për vitin 2020.

Kryesuesi Hyseni gjatë këtij takimi ka thënë së Plani i punës i KPK-së ka për qëllim ofrimin e drejtësisë në mënyrë efikase, efektive, transparente, llogaridhënëse dhe profesionale.

Në këtë takim janë diskutuar objektivat kryesore të Planit të punës të KPK-së për vitin 2020, siç janë: fuqizimi i kornizës nënligjore dhe strukturës organizative, ngritja profesionale e prokurorëve, fuqizimi i integritetit dhe avancimi i sistemit të vlerësimit të prokurorëve.

Po ashtu, është diskutuar për definimin e objektivave që lidhen me ngritjen e transparencës, ngritjen profesionale të stafit administrativ, ngritjen e bashkëpunimit me institucione vendore dhe ndërkombëtare, avancimin e teknologjisë informative dhe disa objektivave të tjera, që kanë për qëllim fuqizimin e sistemit prokurorial të Kosovës.

Diskutohet për planifikimet e punëve të njësive të Sekretariatit për vitin 2020

Prishtinë, 9 janar 2020 – Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Lavdim Krasniqi, ka mbajtur takim me udhëheqësit e departamenteve dhe njësive të tjera të Sekretariatit.

Gjatë këtij takim është biseduar për planifikimet e punëve të njësive të Sekretariatit për vitin 2020, planifikime këto, të cilat burojnë nga Plani i punës për vitin 2020 i KPK-së dhe dokumentet e tjera strategjike të sistemit prokurorial.

Drejtori Krasniqi me këtë rast, ka thënë se administrata duhet të caktojë agjendat periodike për realizimin e planit të punës të paraparë nga ta.

Në këtë takim, i cili ishte i pari për këtë vit është diskutuar edhe për shumë proces të tjera të punës dhe për mundësitë e ndryshimeve në veprime gjatë realizimit të planeve të punës, me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe efektivitetit për arritjen e objektivave.

Diskutohet Udhëzuesi për menaxhimin e sigurisë së objekteve të sistemit prokurorial

Prishtinë, 10 janar 2020 – Komisioni për Çështje Normative i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i udhëhequr nga kryesuesi Zejnullah Gashi, ka mbajtur takimin e parë për vitin 2020, me ç'rast është diskutuar për Udhëzuesin për sigurimin, ruajtjen, qasjen dhe rendin në objektet e sistemit prokurorial.

Në këtë takim, përveç anëtarëve të Komisionit për Çështje Normative, kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e Zyrës Ligjore të Sekretariatit të KPK-së dhe përfaqësuesit e Organizatës Joqeveritare "Grupi për Studime Juridike dhe Politike".

Ky udhëzues ka për qëllim menaxhimi e sigurisë së objekteve të sistemit prokurorial, koordinimin e punës në mes të personelit të sigurisë dhe ofrimin e një ambienti të sigurt në objektet e sistemit prokurorial. Sa i përket këtij udhëzuesi, fillimisht janë hartuar dy drafte, me ç'rast janë diskutuar disa dispozita të rëndësishme, që, sipas propozimeve konkrete të dala nga ky takim, do të jenë pjesë e udhëzuesit, i cili do të dalë për aprovim në Këshill.

Reagim i Këshillit Prokurorial dhe Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit ndaj kërcënimeve të bëra ndaj prokurores speciale, Drita Hajdari

Prishtinë, 11 janar 2020 – Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dënojnë fuqishëm kërcënimin me likuidim fizik dhe kërcënimet e tjera të bëra gjatë ditës së sotme ndaj prokurores speciale, Drita Hajdari.

Këto kërcënime serioze ndaj prokurores Hajdari vijnë si rrjedhojë e fushatës dhe gjuhës denigruese publike nga një grup individësh pas shpalljes së aktgjykimit nga Gjykata Themelore e Prishtinës në lidhje me rastin e ashtuquajtur "Pronto".

Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit qëndrojnë fuqishëm në përkrahje të prokurores speciale, Drita Hajdari, duke i ofruar mbështetjen e plotë për punën dhe përkushtimin e saj në ushtrimin e funksionit kushtetues dhe ligjor në hetimin dhe ndjekjen e kryeseve të veprave penale.

Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit sigurojnë opinionin publik se kërcënimet publike ndaj prokurorëve nuk do t'i zmbrapsin asnjë hap dhe asnjë çast synimet dhe përpjekjet tona të vazhdueshme për krijimin e shtetit ligjor, në të cilin respektohen parimet e drejtësisë.

Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit njoftojnë se kërcënimet ndaj prokurores, Drita Hajdari, janë duke u trajtuar seriozisht dhe me nivelin

e duhur të urgjencës, me ç'rast është urdhëruar Policia e Kosovës që të ndërmarrë masa konkrete për identifikimin dhe arrestimin e personave, të cilët kanë kërcënuar prokuroren Hajdari, si dhe të njëjtit të dalin para organeve të drejtësisë.

Mbahet takimim i 176-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Prishtinë, 14 janar 2020 – Fuqizimi i kornizës ligjore dhe integritetit, transparenca dhe llogaridhënia sistematike, avancimi i sistemit për vlerësimin e performances së prokurorëve, ishin vetëm disa nga shtyllat kryesore që përmban Plani i punës së Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) për vitin 2020, i miratuar sot në takimin e 176-të të vet.

Gjithashtu, Këshilli i udhëhequr nga Kryesuesi i tij, Bahri Hyseni, ka miratuar Rregulloren për trajnime dhe zhvillimin profesional në sistemin prokurorial, e cila përcakton standardet dhe udhëzimet e trajnimit të prokurorëve dhe personelit tjetër, si dhe mbikëqyrjen e zhvillimit profesional të prokurorëve dhe personelit administrativ në sistemin prokurorial.

Rrjedhimisht gjatë takimit janë miratuar rekomandimet e Raportit të Komisionit për transferimin dhe avancimin e tre prokurorëve të shtetit, me ç'rast avancohet një prokurore në Prokurorinë Themelore të Pejës nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin për Krime të Rënda, e cila njëkohësisht do të transferohet për një periudhë

njëvjeçare në Prokurorinë Themelore të Gjakovës, kurse një prokurore e Prokurorisë Themelore në Prizren është avancuar nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin për të Mitur. Në këtë kontekst, pas shpalljes së brendshme për avancimin e një pozite në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës është konstatuar se nuk janë plotësuar kriteret e kërkuara dhe është vendosur të bëhet rishpallja e brendshme.

Nga ana tjetër, në kuadër të përmirësimit të njohurive dhe aftësive të mentorimit për t'u marrë me rastet e synuara të Prokurorit të Shtetit, KPK-ja ka dhënë pëlqimin që grupi i përzgjedhur i prokurorëve për të ndjekur programin e mentorimit në katër module gjatë muajve mars, qershor, shtator dhe nëntor të vitit 2020 në Londër, ndërsa shpenzimet do të mbulohen nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar.

Prezantohen aktivitetet e realizuar të Grupit punues për zhvillim institucional

Prishtinë, 15 janar 2020 – Ecuria e realizimit të objektivave të parapara me fokus në aktivitetet e realizuara për implementimin e objektivit të fuqizimit të komunikimit të brendshëm dhe jashtëm ishte përmbajtja e takimit të tretë të mbajtur në mes të përfaqësuesve të sistemit prokurorial të Kosovës dhe atyre britanikë të projektit "Forcimi i sistemit gjyqësor në Kosovë".

Në këtë takim, në të cilin morën pjesë Kryesuesi i Komisionit për Çështje Normative, Zejnullah Gashi, Kryesuesja e Komisionit për Administrimin e Prokurorive, Radica Miliq, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, Lavdim Krasniqi, si dhe stafi tjetër menaxherial i Këshillit, është diskutuar për aktivitetet e realizuara lidhur me fuqizimin e komunikimit të brendshëm dhe jashtëm me qëllim të koordinimit më të mirë të punëve dhe të ngritjes së transparencës dhe llogaridhënies.

Në këtë takim u bisedua edhe për aktivitetet që do të realizohen në vazhdim, ku u caktuan punët që do të realizohen dhe afatet kohore të përfundimit të tyre.

Mbahet takim i njësive organizative për fuqizimin e promovimit të aktiviteteve

Prishtinë, 15 janar 2020 – Njësitë organizative të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës (SKPK) dhe Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive kanë mbajtur një takim të përbashkët koordinues, në fokus të të cilit ishte komunikimi i brendshëm dhe fuqizimi i promovimit të aktiviteteve dhe punëve të administratës së sistemit prokurorial.

Rrjedhimisht gjatë këtij takimi është diskutuar për avancimin dhe fuqizimin konkret të komunikimit të brendshëm, me ç'rast pjesëmarrësit dhanë disa rekomandime për realizimin e promovimit të suksesshëm të aktiviteteve që ndërlidhen me punët, bashkëpunimin ekipor, ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies.

Ky ishte takimi i parë për vitin 2020, i mbajtur në mes të përfaqësuesve dhe zyrtarëve të njësive organizative të sistemit prokurorial të Kosovës dhe, në këtë kuadër, do të mbahen edhe takime të tjera përgjatë këtij viti kalendarik.

U mbajt takimi i radhës i Bordit Drejtues të Projektit TIK/SMIL

Prishtinë, 16 janar 2020 - Në ambientet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGjK) është mbajtur takimi i tridhjetenjë me radhë i Bordit Drejtues të Projektit TIK/SMIL, ku të pranishëm në takim ishin Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Bahri Hyseni, Kryesuesi i KGJK-së, Skender Çoçaj dhe anëtarë të këtij bordi.

Në këtë takim u prezantua draftraporti i rezultateve të arritura të Projektit SMIL për periudhën korrik - dhjetor të vitit 2019, Raporti financiar i Partnerit Implementues (IMG), raportet e bashkëfinancimit të projekteve KGJK-së dhe KPK-së, si dhe Plani i punës për vitin 2020.

Po ashtu janë shpalosur edhe aktivitetet kryesore, me të cilat është marrë Projekti SMIL, siç janë regjistrimi i lëndëve të vjetra, trajnimet dhe zbatimi i SMIL-it në prokurori dhe gjykata për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2019.

KPK dhe KGJK diskutojnë prioritetet e përbashkëta për vitin 2020

Prishtinë, 16 janar 2020 – Kryesuesi i Këshillit Prokuroril të Kosovës, Bahri Hyseni, ka zhvilluar një takim pune me Kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Skënder Çoçaj, takim ky, në të cilin morën pjesë edhe drejtorët e përgjithshëm të dy sekretariateve përkatëse.

Qëllim i takimit ishte diskutimi i bashkëpunimit të ndërsjellë dhe koordinimi i aktiviteteve gjatë procesit të punës dhe prioriteteve të përbashkëta institucionale për vitin 2020.

Ndër të tjera, kryesuesit e dy Këshillave janë pajtuar në këtë takim që të ketë unifikim në vendimmarrje sa u përket kompetencave të natyrës së përbashkët, siç janë: performansa e prokurorëve dhe gjyqtarëve, disiplinimi, rekrutimi, transferimi dhe avancimi i tyre, si dhe respektimi i kodeve etike përkatëse në sistemin prokurorial dhe atë gjyqësor të Kosovës.

Kryesuesi Hyseni: Kemi aplikuar standarde të larta në rekrutimin, vlerësimin, disiplinimin dhe trajnimin e prokurorëve

Prishtinë, 17 janar 2020 – Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Bahri Hyseni, ka marrë pjesë në Konferencën vjetore të prokurorëve të shtetit.

Në hapje të kësaj konference, në emër të KPK-së, Kryesuesi Hyseni ka mbajtur një fjalë rasti para të pranishmeve, me ç'rast ka thënë, si në vijim:

"Është kënaqësi e veçantë për mua që në emër të Këshillit Prokurorial të Kosovës të ju dëshiroj mirëseardhje në Konferencën Vjetore të Prokurorëve.

Nuk ka shumë kohë që kemi përfunduar një vit pune, në të cilin së bashku shënuam shumë rezultate, me të cilat mund të krenohemi, por edhe filluam një vit, tashmë kur përpara na presin sfida të shumta që presin vëmendjen tonë.

Sot kur jam këtu para jush ndihem krenar për të arriturat e përbashkëta dhe po ashtu ndihem i vendosur t'ju them se do të vazhdojmë të avancojmë sistemin prokurorial, duke

aplikuar standarde të larta në rekrutimin, vlerësimin, disiplinimin dhe trajnimin e prokurorëve.

Ne do të vazhdojmë të ngrisim nivelin e llogaridhënies, efikasitetit, cilësisë së punës në zgjidhjen e rasteve dhe transparencës.

Ne në vazhdimësi kemi pasur objektiva për të krijuar kushte më të mira për punë, numër të mjaftueshëm të prokurorëve dhe stafit administrativ, si dhe pajisje më moderne për punë, andaj, sot, dua ta theksoj se të gjithë jemi dëshmitarë se tashmë pothuajse të gjitha këto objektiva i kemi arritur si Këshill.

Këto të arritura nuk janë bërë vetvetiu, por falë një pune intensive të Këshillit Prokurorial me të gjitha njësitë e tij, siç janë Komisionet e Këshillit, Sekretariati dhe Njësiti i Performancës së Prokurorisë.

Ne kemi avancuar sistemin e planifikimit, duke punuar së bashku, kemi rritur buxhetin përmes një planifikimi më të mirë dhe një shpenzimi më efektiv. Këtu dua të theksoj se buxheti i miratuar për sistemin prokurorial për vitin 2019 është shpenzuar 98 %, ndërsa raporti i Auditorit të Zyrës Kombëtare të Auditorit ishe një ndër më të mirët deri më tani me vetëm dy rekomandime, të cilat janë implementuar në tërësi.

Ne kemi arritur që për herë të parë pas shumë viteve të rekrutojmë numrin e planifikuar të prokurorëve dhe aktualisht në sistem kemi numrin e mjaftueshëm të prokurorëve.

Ne sapo kemi përfunduar emërimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale dhe Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe së shpejti do të fillojmë rekrutimin e prokurorëve të rinj në zëvendësim të atyre që shkojnë në pension.

Nuk mund të mos theksoj këtu punën që është bërë aktualisht nga Akademia e Drejtësisë për trajnimin fillestar të 12 prokurorëve të rinj, të cilët pritet që së shpejti të përfundojnë trajnimin dhe të fillojnë punën me raste.

Për të gjithë prokurorët e rekrutuar aktualisht kemi rekrutuar stafin e domosdoshëm dhe jemi në proces të rekrutimit të stafit tjetër të nevojshëm.

Këshilli përmes Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve ka vlerësuar prokurorë të niveleve të ndryshme sipas një planifikimi paraprak vjetor dhe ka filluar reformimin e sistemit të vlerësimit të performancës. Në këtë drejtim jemi duke punuar intensivisht me ekspertë vendorë dhe partnerët tanë ndërkombëtarë në hartimin e një rregulloreje të re, e cila do ta avancojë edhe më tutje sistemin e vlerësimit të performancës.

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si Këshill i kemi përfunduar të gjitha obligimet ligjore, duke hartuar aktet përkatëse nënligjore, kemi themeluar panelet disiplinore, kemi aprovuar Kodin e ri të etikës për prokurorë dhe kemi transferuar stafin përgjegjës për mbështetjen e paneleve. Me bindje

të plotë them se përkundër sfidave kemi arritur të përfundojmë me sukses procedurat në disa raste disiplinore ndaj prokurorëve dhe i kemi përfunduar të gjitha sipas afateve ligjore.

Ndër të arriturat kryesore, dua të theksoj edhe avancimin e sistemit të menaxhimit të rasteve përmes sistemit elektronik të menaxhimit të rasteve, i njohur si SMIL. Është punuar shumë deri më tani në këtë drejtim dhe jam krenar të them se pas një pune të shkëlqyeshme të prokurorëve dhe stafit të sistemit prokurorial sot pranojmë rastet e reja dhe i punojmë ato përmes këtij sistemi. Gjithashtu kemi arritur që për një kohë rekorde (për 4 muaj) të regjistrojmë të gjitha lëndët e vjetra në SMIL. Këshilli e ka prioritet të lartë aplikimin e këtij sistemi dhe me vendim të veçantë e ka bërë të obligueshëm zbatimin e tij nga çdo prokuror dhe staf i prokurorisë.

Vlen të përmendet se Këshilli ka miratuar dhe është duke zbatuar Planin strategjik të sistemit prokurorial 2019-2021, në të cilin janë përcaktuar objektivat trevjeçare të tërë sistemit prokurorial.

Këshilli ka miratuar po ashtu Strategjinë për Krime të Luftës dhe ka themeluar mekanizmat e paraparë për implementimin e kësaj strategjie, si: Task Forca dhe grupi monitorues që në përbërjen e tij ka përfaqësues të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Prokurorisë së Shtetit, Policisë së Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë. Vlen të përmendet se ky dokument është me karakter nacional dhe ka mundësuar që Departamenti për Krime Lufte të trajtojë me prioritet rastet e kësaj natyre.

Si Këshill kemi punuar shumë edhe në drejtim të zhvillimit profesional të prokurorëve, duke caktuar nevojat për trajnime të prokurorëve dhe personelit administrativ, si dhe aktualisht e kemi hartuar një rregullore të veçantë, përmes të cilës do të përcaktohen parimet, kriteret dhe metodologjitë më të avancuara për koordinim më të mirë të trajnimit të prokurorëve përmes Akademisë së Drejtësisë dhe partnerëve të tjerë të Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit.

Ne kemi punuar intensivisht edhe për të ngritur nivelin e sigurisë për prokurorë dhe personel, por na duhet të bëjmë edhe më shumë në drejtim të rritjes së nivelit të sigurisë. Si Këshill mbesim të përkushtuar të mbrojmë me çdo mjet secilin prokuror, i cili ushtron kompetencat kushtetuese dhe ligjore.

Meritat për të arriturat tona dua t'ia atribuoj edhe mbështetjes së partnerëve tanë, të cilët ishin dhe janë me ne në rrugën tonë të përbashkët. Me respekt të lartë çmoj mbështetjen e Ambasadës Amerikane, Zyrës së Bashkimit Evropian, Ambasadës së Mbretërisë Norvegjeze, Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar, Ambasadës së Mbretërisë së Holandës, UNDP-së, GIZ-it, IRZ-së, OSBE-së, Këshillit të Evropës etj.

Të gjithë ne e dimë se sistemi i drejtësisë në përgjithësi dhe ai gjyqësor e prokurorial në veçanti kanë kaluar nëpër periudha të ndryshme reformash. Që nga koha kur Gjyqësori u administrua nga ndërkombëtarët e deri në ditët e sotme janë bërë shumë ndryshime e dhe padyshim se mund të theksojmë se kishte dhe ka një avancim gradual.

Reformat, përmes të cilave kemi kaluar që nga paslufta kishin të bëjnë jo vetëm me ndryshime të ligjeve bazike të të gjitha lëmive të së drejtës, por edhe me ndryshime dhe reformim të strukturës së prokurorive dhe jo vetëm. Për të tejkaluar me sukses të gjitha reformat dhe zhvillimet nuk ishte e lehtë dhe shumicës nga ne mund t'i kujtohen shumë momente sfiduese të kaluara përgjatë këtyre proceseve.

Në një ditë si kjo, ne patjetër se duhet t'i kujtojmë ato zhvillime reformuese, por edhe duhet ta pyesim veten se çka mund të bëjmë më tepër që të përmirësojmë kushtet e punës dhe pozitën tonë, por gjithashtu duhet që të punojmë më tepër dhe qytetarëve të vendit tonë, pa dallim, t'u ofrojmë drejtësi.

Dy vjetët e kaluara është punuar shumë lidhur me rishikimin funksional të sektorit të Drejtësisë dhe duke qenë pjesë e rëndësishme e objektivave për ndryshim kemi caktuar objektiva të qarta për avancim dhe ndryshim . Do të punojmë ngushtë me të gjithë partnerët tanë në këtë drejtim dhe ju garantoj që do të mbrojmë vlerat dhe interesat më të mira të prokurorëve dhe stafit të sistemit prokurorial.

Që të kemi besimin e publikut në punën tonë duhet të punojmë pa u ndaluar dhe të krijojmë një ambient ku ka qasje më të lehtë në drejtësi për të gjithë. Andaj, dua të përmend shkurtimisht se disa nga prioritetet e Këshillit për këtë vit do të jenë:

Fuqizimi i kornizës ligjore dhe strukturës organizative të sistemit prokurorial;

Ngritja e nivelit të llogaridhënies dhe kontrollit permanent të punës së prokurorëve;

Fuqizimi i integritetit të prokurorëve dhe stafit administrativ;

Avancimi i sistemit të vlerësimit të performancës së prokurorëve;

Ngritja e nivelit të transparencës;

Avancimi i kritereve për rekrutim meritorë;

Zhvillimi i mëtejmë i sistemit të ngritjes në karrierë;

Përmirësimi i nivelit të menaxhimit dhe administrimit;

Përmirësimi i vazhdueshëm i planifikimit, buxhetit dhe kushteve për punë;

Ngritja profesionale e prokurorëve dhe stafit administrativ dhe

Bashkëpunimi dhe koordinimi më i mirë me partner vendorë dhe ndërkombëtarë.

Në fund, dua të theksoj edhe njëherë nevojën për mbështetje të sistemit prokurorial nga të gjithë, sepse vetëm së bashku mund ta fuqizojmë një sistem prokurorial të pavarur, profesional, transparent, efikas, efektiv dhe llogaridhënës.

Përfundimisht vlerësoj rëndësinë e madhe të kësaj konference, prandaj duke i falënderuar të gjitha ata që punuan në organizim të saj, ju dëshiroj punë të mbarë sot dhe suksese në të ardhmen."

Prezantohen zhvillimet në administratën e sistemit prokurorial të Kosovës

Prishtinë, 17 janar 2020 – Në kuadër të Konferencës vjetore të prokurorëve, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Lavdim Krasniqi, ka folur para të pranishmëve për administratën e sistemit prokurorial.

Drejtori Krasniqi ka thënë fillimisht se administrata e sistemit prokurorial ndahet në dy pjesë - në atë të Këshillit Prokurorial dhe Prokurorit të Shtetit, të cilën e përbën një numër i përgjithshëm i personelit prej 652 personash, 556 nga Prokurori i Shtetit dhe 86 nga Sekretariati i KPK-së, së bashku me Njësitin për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë (NJSHPP).

Z.Krasniqi theksoi se rrjedhimisht Sekretariati i KPK-së ndihmon Këshillin në zbatimin e rregullave, rregulloreve dhe politikave lidhur me menaxhimin, buxhetin dhe administrimin e prokurorive, zhvillon dhe propozon rregulla administrative për zbatimin e vendimeve të Këshillit, i propozon Këshillit politika, rregulla dhe rregullore për administrimin efikas dhe efektiv të prokurorive, si dhe sipas udhëzimeve të Këshillit dhe Komisionit përgatit draftbuxhetin dhe administron buxhetin e miratuar.

Po ashtu, sipas udhëzimeve të Këshillit dhe Komisionit përkatës, menaxhon personelin administrativ të prokurorive, përfshirë vlerësimin e performancës dhe siguron që prokuroritë të kenë furnizim të duhur me materiale për funksionim të rregullt dhe ofron mbështetje administrative për Këshillin, komisionet e tij dhe Prokurorin e Shtetit.

Në kuadër të Këshillit Prokurorial funksionon Njësiti për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë (NJSHPP), i cili mbikëqyr dhe raporton për punën e prokurorive, mbështet procesin e vlerësimit të performancës së prokurorëve dhe prokurorive, përgatit raporte të rregullta statistikore sipas kërkesave të KPK-së dhe PSH-së, si dhe kryen verifikimin prokurorial dhe mbështet procesin e emërimit, avancimit dhe transferimit të prokurorëve.

Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së, Lavdim Krasniqi, theksoi se synohet rritja e vazhdueshme e profesionalizimit dhe efikasitetit të punës, avancimin e llogaridhënies dhe integritetit personal të zyrtarëve, riorganizimi dhe klasifikimi i pozitave brenda sistemit prokurorial, rritja e numrit të personelit dhe rishikimi i proceseve të punës në përputhje me nevojat e sistemit prokurorial, si dhe rregullimin e statusit të zyrtarëve të administratës sipas parimeve kushtetuese.

Ndërkaq, sipas tij, sfidat e administratës së sistemit prokurorial janë: struktura aktuale dhe rregullimi ligjor aktual, mosharmonizimi i legjislacionit për nëpunësit civilë me nevojat e strukturës së sistemit prokurorial, pamundësia e përfshirjes së strukturës së re të propozuar në procesin e klasifikimit të pozitave siç është përcaktuar në Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, si dhe mospërputhja e afateve kohore për përgatitjen e dokumenteve për klasifikimin e pozitave dhe atij për hartimin e akteve përkatëse nënligjore për riorganizim.

Mbahet takimi i radhës i Komisionit për Çështje Normative

Prishtinë, 21 janar 2020 – Komisioni për Çështje Normative, i udhëhequr nga kryesuesi i tij, Zejnullah Gashi, ka diskutuar draftin e Rregullores për organizimin dhe veprimtarinë e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe listën me emërtimet e dokumenteve, lëndëve, regjistrave dhe afatin e ruajtjes së tyre në sistemin prokurorial.

Në këtë kontekst, në takimin e sotëm është diskutuar caktimi dhe mënyra e rrjedhës së takimeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme të Këshillit Prokurorial, inkorporimi dhe ristrukturimi i ndryshimeve sipas komenteve të anëtarëve të Komisionit dhe organizimi i dëgjimit publik për draftin e Rregullores për organizimin dhe veprimtarinë e KPK-së.

Rrjedhimisht, temë diskutimi ishte edhe dhe roli dhe rëndësia e listës me emërtimet e dokumenteve për KPK-në, me fokus të veçantë për arkivin e saj, pastaj rishqyrtimi i afateve dhe koordinimi i veprimeve me Ministrinë e Administratës Publike, e cila është duke e përgatitur një draftrregullore për këto çështje.

Mbahet takimi i njësive organizative të Sekretariatit të KPK-së

Prishtinë, 21 janar 2020 – Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës (SKPK), Lavdim Krasniqi, ka mbajtur një takim me disa nga udhëheqësit e njësive organizative, Auditorin e Brendshëm dhe zyrtarë të tjerë të Zyrës së tij.

Në këtë takim është diskutuar për të gjeturat e Auditorit të Brendshëm, me ç'rast janë shpalosur rekomandimet që kanë dalë nga raporti i fundit.

Rrjedhimisht gjatë diskutimeve u trajtuan këto të gjetura, disa prej të cilave janë zbatuar tërësisht, kurse në fokus ishin vetëm ato të cilat janë në proces të zbatimit.

Miratohet Raportit vjetor financiar për vitin 2019 i sistemit prokurorial

Prishtinë, 23 janar 2020 – Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i udhëhequr nga Kryesuesja, Prokurorja Dëshirë Jusaj, ka mbajtur takimin e radhës, në të cilin përveç anëtarëve të komisionit, kanë marrë pjesë edhe Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së, Lavdim Krasniqi, si dhe zyrtarë të njësive përkatëse të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Qëllimi i këtij takimi ishte shqyrtimi i Raportit vjetor financiar për vitin 2019 të sistemit prokurorial të Kosovës, të cilin e ka prezantuar Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, duke përfshirë të gjitha programet buxhetore të Këshillit sipas kategorive ekonomike, raport ky, i cili u miratua pa vërejtje nga Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel, por me rekomandim që në raport të paraqitet tabela e realizimit të buxhetit sipas programeve, si dhe të paraqiten obligimet e mbetura të vitit 2019.

Gjithashtu, në takim Drejtori i Përgjithshëm e ka prezantuar para anëtarëve të Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel edhe Planin e personelit për vitin 2020, i cili po ashtu u miratua nga Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel.

Prezantohet Plani i prokurimit për vitin 2020

Prishtinë, 24 janar 2020 – Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Lavdim Krasniqi, ka mbajtur një takim me të gjithë udhëheqësit e njësive kërkuese të prokurimit, me ç'rast është bërë edhe prezantimi i Planit të punës së prokurimit për vitin 2020 për sistemin prokurorial të Kosovës.

Në fillim të këtij takimi, Drejtori Krasniqi, tha së formati i tillë i prezantimit të Planit të prokurimit ka për qëllim ngritjen e komunikimit në mes të Divizionit të Prokurimit dhe njësive kërkuese, ku si objektiv ka realizimin sa më të mirë të këtij plani.

Ndërsa, Udhëheqësja e Divizionit të Prokurimit në Sekretariatin e KPK-së, Flora Doda, tha se Plani i Prokurimit për vitin 2020 ka paraparë nevojat dhe kërkesat e sistemit prokurorial në përgjithësi. Ajo shtoi se në plan janë të caktuar edhe afatet kohore për secilën fazë tenderuese.

Plani i Punës së prokurimit për vitin 2020 i sistemit prokurorial të Kosovës ka bërë harmonizimin e nevojave të këtij sistemi me buxhetin e paraparë për këtë vit.

Prezantohet drafti i Rregullores për organizimin dhe veprimtarinë e KPK-së

Prishtinë, 28 janar 2020 – Përcaktimi i mënyrave të punës, organizimi dhe veprimtaria e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe i komisioneve të tij, ishte në fokus të takimit të sotëm të Komisionit për Çështje Normative, me ç'rast është bërë prezantimi i draftit të Rregullores për organizimin dhe veprimtarinë e Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Në këtë takim, i cili është udhëhequr nga Kryesuesi i tij, Zejnullah Gashi, përveç anëtarëve të Komisionit, kanë marrë pjesë edhe Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së, përfaqësues të Ambasadës së SHBA-së, Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar, Grupit për Studime Juridike dhe Politike dhe Zyrës Ligjore të SKPK-së.

Në këtë kontekst, Kryesuesi Gashi ka shprehur falënderim për pjesëmarrësit dhe grupin punues për kontribut në draftimin e kësaj rregulloreje të rëndësisë së veçantë për lehtësimin e punës dhe funksionimit sa më praktik të Këshillit, me ç'rast kanë dhënë komentet e tyre përfaqësuesit e ambasadave dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, të cilat janë inkorporuar në draftin final.

Publikohet Doracaku për procedurat e ndërmjetësimit

Prishtinë, 30 janar 2020 – Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me UNDP-në publikuan sot Doracakun për procedurat e ndërmjetësimit alternativ gjyqësor për zgjidhjen e kontesteve mes palëve, me ç'rast morën pjesë Kryesuesi i KPK-së, Bahri Hyseni, Kryesuesi i KGJK-së, Skender Çoçaj, prokurorë, gjyqtarë, përfaqësues të tjerë të sistemit të drejtësisë dhe ambasadave në Kosovë.

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial, Bahri Hyseni, gjatë fjalës së tij, ka thënë se Doracaku për procedurat e ndërmjetësimit do të jetë një dokument i rëndësishëm, të cilin prokurorët, gjyqtarët dhe stafi profesional do ta kenë para vetes përditë, ngaqë ofron qasje të lehtë për zgjidhjen praktike të konflikteve dhe mosmarrëveshjeve në procedurë jashtëgjyqësore, garanton zvogëlim të lëndëve dhe funksionim më efikas të sundimit të ligjit, si dhe avancim më të madh të kësaj procedure në funksion të zgjidhjes së rasteve penale dhe civile në Kosovë".

Në këtë kontekst, edhe Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor, Skënder Çoçaj, ka vlerësuar lart rolin dhe rëndësinë e publikimit të këtij doracaku, duke thënë se procedurat e ndërmjetësimit do të ndikojnë drejtpërsëdrejti në ngritjen e efikasitetit, përmirësimin e performancës dhe imazhit të sistemit gjyqësor, rritjen e besueshmërisë së publikut, si dhe ofrimin e zgjidhjeve alternative më të lehta dhe më të shpejta për qytetarët, duke përmirësuar dukshëm sistemin gjyqësor.

Po ashtu, autori i Doracakut, Prokurori në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, ka folur rrjedhimisht për përmbajtjen, sfidat me te cilat është ballafaquar gjatë punës, identifikimin e çështjeve kryesore dhe zbatimin praktik të këtij akti nënligjor, duke cekur se risi të veçantë përfshirjen e dhunës në familje.

Nga ana tjetër, në vijim të takimit që iu kushtua këtij doracaku, hartimi dhe publikimi i të cilit është mbështetur nga UNDP-ja dhe financuar nga Ambasada e Norvegjisë në Kosovë, është zhvilluar një debat për implementimin e tij në institucionet gjyqësore dhe prokuroriale, me ç'rast folësit janë zotuar se do të tejkalojnë vështirësitë dhe sfidat eventuale, duke ofruar mbështetjen e pakursyer për përdorimin e tij në funksion të lehtësimit të procedurave alternative.

Prezantohen pamjet vizuale të sistemit elektronik për menaxhimin e lëndëve të ZMNV-së

Prishtinë, 31 janar 2020 – Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës ka organizuar punëtori dyditore për prezantimin vizual të sistemit elektronik të menaxhimit të lëndëve për Zyrën për Mbrojtjen dhe Ndihmë Viktimave, e cila është mbështetur nga GIZ-i gjerman, punëtori kjo, të cilën e kanë kryesuar Udhëheqësi i Departamentit të Teknologjisë Informative, Nexhat Haziri dhe Menaxheri i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave, Basri Kastrati.

Rrjedhimisht në kuadër të kësaj punëtorie janë prezantuar katër faza pune që do të zgjasin gjer në përfundim të këtij projekti, të cilat përfshijnë: definimin e kërkesave funksionale, pamjet vizuale të sistemit, zhvillimin e sistemit, zbatimin dhe trajnimin e stafit të ZMNV-së.

Gjithashtu, Grupi punues ka draftuar edhe Rregulloren për administrimin e punës së Zyrës për Mbrojtjen dhe Ndihmë të Viktimave, e cila do të shërbejë për mbrojtësit e viktimave dhe do të jetë në përputhje me sistemin elektronik, i cili do ta bëjë punën më të lehtë dhe më efikase gjatë menaxhimit të lëndëve për mbrojtjen e viktimave.

Mbahet takimi i 177-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Prishtinë, 31 janar 2020 - Këshilli Prokurorial i Kosovës, i udhëhequr nga Kryesuesi Bahri Hyseni, në takimin e sotëm ka miratuar Udhëzimin Administrativ për sigurimin, ruajtjen, qasjen dhe rendin në objektet e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.

Ky akt nënligjor përcakton përgjegjësitë e sigurimit dhe procedurat e kontrollit, me qëllim të ngritjes së nivelit të sigurisë dhe krijimit të një ambienti të sigurt për të gjithë personat zyrtarë dhe jozyrtarë, të cilët kanë qasje brenda objekteve të sistemit prokurorial.

Gjithashtu, anëtarët e Këshillit Prokurorial kanë miratuar Raportin e Grupit punues për mbikëqyrjen e Njësitit për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike në Prokurorinë Themelore të Prishtinës, raport ky, që është në përputhje të plotë me Planin strategjik të sistemit prokurorial 2019-2021, të cilin e ka prezantuar prokurorja në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Laura Pula.

Po ashtu gjatë takimit është miratuar edhe lista e prokurorëve, të cilët do të vlerësohen gjatë vitit 2020 dhe janë marrë vendime të tjera nga fushëveprimtaria e KPK-së.

Sekretariati i KPK-së

Në kuadër të përgjegjësive administrative dhe mbështetjes për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe prokuroritë, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Lavdim Krasniqi, ka zhvilluar takime të ndryshme me qëllim të fuqizimit dhe ngritjes profesionale të administratës së sistemit prokurorial për ngritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në punë. Po ashtu ka koordinuar punët dhe aktivitetet e administratës së Sekretariatit të KPK-së dhe administratës së prokurorive.

Zyra Ligjore ka hartuar akte juridike, ka analizuar dhe ofruar mendime juridike për aktet e hartuara nga njësitë e Sekretariatit të Këshillit, si dhe ka mbeshtetur komisionet dhe trupat e tjerë në hartimin e akteve nënligjore dhe dokumenteve të tjera.

Zyra për Komunikim Publik (ZKP) ka përcjellë aktivitetet e Kryesuesit të Këshillit, me ç'rast ka prezentuar punët e tyre përmes mjeteve të informimit publik. Ka përgatitur 23 materiale për publikun. Ka realizuar kërkesat e mediave dhe OJQ-ve lidhur me interesimin e tyre për t'u njoftuar me punët, aktivitetet dhe proceset e zhvilluara, ato në vijim dhe që pritet të zhvillohen në sistemin prokurorial. Po ashtu është angazhuar në fuqizimin e komunikimit të brendshëm.

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka përgatitur Raportin vjetor për Njësinë Qendrore të Harmonizuar të Auditimit të Brendshëm.

Zyra për Administrimin dhe Arkivimin e Dokumenteve, gjatë muajit janar 2020, ka proceduar me këto aktivitete, si në vijim: shkresa hyrëse 29, shkresa dalëse 30, fatura të pranuara nga prokuroritë dhe operatorët e ndryshëm 514 dhe 38 vendime. Zyra për Përkthim dhe Lekturim, e cila vepron në kuadër të Divizionit për Administratë ka përkthyer 451 faqe të materialeve dhe 23 orë përkthim simultan.

Divizioni për Buxhet dhe Financa ka përfunduar dhe dërguar në Ministrinë e Financave Raportin e pasqyrave financiare për vitin 2019.

Departamenti i Teknologjisë Informative ka filluar pilotimin e shkëmbimit të të dhënave në mes të sistemit elektronik të Policisë së Kosovës dhe sistemit të prokurorisë (SMIL). Ky proces është duke u kryer në Prokurorinë Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda (DRK). Gjithashut është publikuar versioni i parë i Sistemit Elektronik për Menaxhimin e Financave. Ky sistem do të përdoret nga Divizioni për Buxhet dhe Financa dhe ka për qëllim digjitalizimin e procesit të punës në këtë divizion.

Njësiti për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive i KPK-së

Njësiti për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive (NJSHPP) ka hartuar draftanaliza për numrin e nevojshëm të prokurorëve, ka monitoruar performancën e SMIL-it për gjenerimin e raporteve statistikore dhe janë adresuar lëshimet e identifikuara.

Njësiti gjatë muajit janar ka hartuar një numër të madh të raporteve, të cilat do të shërbenin për Zyrën e koordinatorit për krime ekonomike dhe sekuestrimin-konfiskimin e pasurisë dhe për organizata joqeveritare. Po ashtu janë përgatitur raporte për Ministrinë e Integrimeve Evropiane, me qëllim të realizimit të agjendave të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit.

Për nevoja të brendshme janë përgatitur statistika dhe raporte të ndryshme në shumë fusha të agjendave ditore të sistemit prokurorial të Kosovës.

Në bashkëpunim me UNDP-në dhe Institucionin e Avokatit të Popullit të Kosovës është organizuar një aktivitet i edukimit ligjor me temën "Sesion informues për përdorimin e platformës për të drejtat e njeriut dhe objektivave për zhvillim të qëndrueshëm". Përfituesit e këtij aktiviteti ishin prokurorë, bashkëpunëtorë profesionalë të prokurorive themelore të Kosovës dhe disa zyrtarët të Sekretariatit të KPK-së.